Funded by
the European Union

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

MANUAL TRAJNIMI PËR PERSONELIN SHËNDETËSOR

PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR

TFL
TOGETHER FOR LIFE

IRCA
INSTITUTE OF ROMANI CULTURE IN ALBANIA

Autorët:

Krisela Pllaha
Mirela Arqimandriti

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, e mbrojtur nga Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet apo përdoret në asnjë formë dhe me asnjë mjet grafik, elektronik apo mekanik – duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në fotokopjim, skanim, digjitalizim, rrjete elektronike apo sisteme të tjera – pa miratimin me shkrim të botuesit.

Për informacion ose komente, ju lutemi kontaktoni: Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
Email: gadc@gadc.org.al

Ky botim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit. Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për asnjë përdorim që mund t'i bëhet informacionit që përmban ky dokument.

Shkurtesa

Shkurtimi	Kuptimi
CEDAW	Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave)
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
DHPI	Dhuna e Partnerit Intim
ETN	Ekipe Teknike Ndërdisiplinore
FIGO	International Federation of Gynecology and Obstetrics (Federata Ndërkombëtare e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës)
GBV	Gender-Based Violence (Dhuna me Bazë Gjinore)
IPV	Intimate Partner Violence (Dhuna nga Partneri Intim)
KVDHF	Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PIK	Pika e Informimit dhe Koordinimit
RM	Raste të Menaxhuara
UNDP	United Nations Development Programme (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim)
UNFPA	United Nations Population Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë)
UN Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VAWG	Violence Against Women and Girls (Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave)
WHO	World Health Organization (Organizata Botërore e Shëndetësisë – OBSH)

Tabela e përmbatjes

SHKURTESA....3
HYRJE....5
INFORMACION NË LIDHJE ME MANUALIN PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR....7
SEKSIONI I – DHUNA ME BAZË GJINORE: KONCEPTET THEMELORE....9

FORMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE....12
TË KUPTUARIT E DINAMIKËS SË DHUNËS NË MARRËDHËNIET INTIME....14
CIKLI I DHUNËS....16
THYERJA E CIKLIT TË DHUNËS....17

SEKSIONI II – IDENTIFIKIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE....18

PARIMET PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË GJATË EKZAMINIMIT PËR DHBGJ....19
SIMPTOMAT, SHENJAT DHE SJELLJET E LIDHURA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE (DHBGJ)....21
SI TË PYETNI PËR DHUNËN ME BAZË GJINORE (DHBGJ)....25

SEKSIONI III – TRAJTIMI DHE DOKUMENTIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE....27

TRAJTIMI I RASTIT TË DHUNËS DHE OFRIMI I KUJDESIT MJEKËSOR....27
DOKUMENTIMI I RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR....33

SEKSIONI IV – VLERËSIMI I RREZIKUT DHE PLANIFIKIMI I SIGURISË....36
SEKSIONI V – RRUGËT E REFERIMIT DHE BASHKËPUNIMI NDËRSEKTORIAL....40

REFERIMI I RASTEVE TË DHBGJ NË SHQIPËRI....42

SEKSIONI VI – ASPEKTET ETIKE DHE KOMUNIKIMI ME VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE....45

PARIMET ETIKE BAZË....45
PARIME TË KOMUNIKIMIT TË NDJESHËM ME VIKTIMAT....46

SEKSIONI VII – TRAJTIMI I GRUPEVE NË RREZIK TË SHTUAR....47

QASJE E PERSONALIZUAR PËR GRUPET NË RREZIK TË SHTUAR....47
SHEMBUJ PRAKTIKË....49

SEKSIONI VIII – NDJEKJA DHE MONITORIMI I RASTEVE TË REFERUARA....50
SEKSIONI IX – TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I VAZHDUESHËM....52

RËNDËSIA E EDUKIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN E DHBGJ....52
CHECKLISTË PËR TRAJNIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË VAZHDUESHËM MBI DHBGJ....54

SEKSIONI X – MENAXHIMI I STRESIT DHE MIRËQENIES SË STAFIT SHËNDETËSOR....55
SEKSIONI XI – ZBATIMI I PROTOKOLLEVE DHE STANDARDEVE INSTITUCIONALE....56
REFERENCAT....58

SHTOJCA 1 - FORMULAR PËR DEPISTIMIN RUTINË TË DHUNËS NË FAMILJE....60

Hyrje

Dhuna me bazë gjinore: një sfidë madhore për shëndetin publik, barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) përbën një ndër format më të rënda të dhunës dhe një shkelje serioze e të drejtave të njeriut, e cila ndikon drejtpërdrejt në jetën, shëndetin dhe dinjitetin e miliona individëve në mbarë botën. Ajo është një dukuri e përhapur që ndodh në të gjitha shtresat shoqërore, kulturat dhe komunitetet, duke prekur në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Në Shqipëri, DHBGJ mbetet një sfidë kritike, e cila shfaqet në forma të shumta dhe ndikon në mënyrë të thellë jo vetëm tek individët e prekur, por edhe në kohezionin social, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien kolektive.

E rrënjosur në struktura patriarkale, pabarazi të vazhdueshme gjinore dhe norma kulturore diskriminuese, DHBGJ manifestohet përmes dhunës në familje, dhunës seksuale, trafikimit të qenieve njerëzore, martesave të detyruara, ngacmimeve seksuale dhe praktikave të dëmshme tradicionale. Këto forma dhune ushqehen nga heshtja shoqërore, mungesa e reagimit institucional, normat e ngulitura që normalizojnë apo justifikojnë dhunën, dhe mungesa e aksesit të barabartë në drejtësi dhe shërbime të mbrojtjes për viktimat.

Adresimi i DHBGJ-së nuk është vetëm një domosdoshmëri morale, por edhe një angazhim politik dhe institucional për të garantuar barazi gjinore dhe për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut. Në thelb të kësaj përpjekjeje qëndron e drejta e çdo individi për të jetuar një jetë të lirë nga dhuna, frika dhe diskriminimi. DHBGJ minon autonominë dhe potencialin e individëve, duke i penguar ata të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Për më tepër, DHBGJ përbën një krizë serioze të shëndetit publik. Viktimat shpesh përballen me pasoja afatgjata që përfshijnë dëmtime fizike, çrregullime të shëndetit mendor si depresioni, ankthi, çrregullimi i stresit post-traumatik, si dhe një rrezik më të lartë për sëmundje kronike. Këto pasoja kanë kosto të larta sociale dhe ekonomike, duke rënduar sistemet shëndetësore, duke ulur produktivitetin dhe duke thelluar varfërinë, veçanërisht për gratë dhe fëmijët që varen nga to.

Përballë një problematike kaq komplekse dhe të ndërlidhur, kërkohet një përgjigje e integruar dhe ndërsektoriale që përfshin institucionet shtetërore, shoqërinë civile, sektorin shëndetësor, sistemin e drejtësisë, arsimin dhe median. Politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë angazhimet e Shqipërisë ndaj Konventës së Stambollit, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) dhe Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ofrojnë kuadrin strategjik për të ndërmarrë veprime të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtje të viktimave dhe në parandalimin e DHBGJ-së.

Investimi në mekanizmat e parandalimit, fuqizimin ekonomik dhe social të grave, edukimin për barazi gjinore, forcimin e sistemit të referimit dhe aksesin në shërbime të specializuara është kyç për të thyer ciklin e dhunës dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe të sigurt për të gjithë.

Roli i personelit shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor në adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore

Kujdesi Shëndetësor Parësor (KSHP) përfaqëson pikën e parë të kontaktit të shumicës së individëve me sistemin shëndetësor dhe ka një rol kyç në zbulimin, trajtimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ). Si një shtyllë themelore e shëndetësisë publike, KSHP ofron një mundësi të veçantë për të ndërhyrë herët, për të mbështetur të mbijetuarit dhe për të promovuar barazi gjinore dhe të drejta të njeriut në nivel komunitar. Forcimi i këtij niveli të kujdesit është një domosdoshmëri për një përgjigje efektive dhe gjithëpërfshirëse ndaj DHBGJ.

Zbulimi dhe ndërhyrja e hershme
Personeli shëndetësor i KSHP-së, përfshirë mjekët, infermierët dhe profesionistët e tjerë, janë shpesh kontakti i parë për gratë dhe vajzat që përjetojnë DHBGJ. Kjo i vendos ata në një pozicion unik për të identifikuar herët shenjat e dhunës — qoftë fizike, psikologjike apo seksuale — dhe për të ndërhyrë me mbështetje të menjëhershme.
Sipas OBSH, kujdesi shëndetësor parësor përbën "linjën e parë të përgjigjes" ndaj DHBGJ dhe është thelbësor për të zbutur ndikimet afatgjata të dhunës në shëndetin dhe mirëqenien e individëve.

Ofrimi i kujdesit dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse
KSHP është projektuar për të siguruar kujdes të vazhdueshëm, të personalizuar dhe të koordinuar. Në kontekstin e DHBGJ, kjo nënkupton adresimin jo vetëm të dëmtimeve fizike, por edhe të nevojave afatgjata për shëndet mendor, riprodhues dhe emocional.
Kjo mund të përfshijë:

- këshillim psikologjik;
- ndërlidhje me specialistë të tjerë;
- referim drejt shërbimeve sociale dhe ligjore;
- orientim drejt strehimoreve apo qendrave mbështetëse.

UN Ëomen thekson rëndësinë e një qasjeje të përqendruar te të mbijetuarit, ku ofrimi i mbështetjes holistike nga KSHP është një element kyç i rimëkëmbjes së tyre.

Sigurimi i konfidencialitetit dhe ndërtimi i besimit
Besimi mes pacientit dhe profesionistit shëndetësor është thelbësor në çështjet që lidhen me DHBGJ. Ambientet e KSHP-së duhet të ofrojnë një hapësirë të sigurt, të ndjeshme dhe jo-gjykuesedhe, ku të mbijetuarit mund të ndihen të dëgjuar dhe të mbështetur.
Privatësia dhe konfidencialiteti janë parakushte për të ndihmuar viktimat të flasin lirshëm, të ndihen të respektuar dhe të kërkojnë ndihmë pa frikë nga stigmatizimi ose pasoja të tjera. Sipas IFRC, ambientet e kujdesit parësor duhet të mbrojnë dinjitetin dhe sigurinë e të mbijetuarve, duke krijuar besim dhe duke nxitur daljen përpara.

Parandalimi dhe edukimi shëndetësor
Personeli i KSHP-së ka një rol të rëndësishëm jo vetëm si reagues, por edhe si edukues dhe avokat për ndryshimin shoqëror.
Ata mund të kontribuojnë në:

- edukimin e pacientëve mbi DHBGJ dhe mënyrat për ta identifikuar;
- rritjen e ndërgjegjësimit mbi shërbimet e disponueshme për mbështetje;
- sfidimin e normave të dëmshme gjinore dhe rolit të gruas në shoqëri;
- promovimin e modeleve të shëndetshme të marrëdhënieve dhe barazisë gjinore.

OBSH thekson se promovimi i barazisë gjinore nëpërmjet sistemit shëndetësor është një strategji kyçe për parandalimin afatgjatë të DHBGJ.

Referimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional
Një nga funksionet kyçe të KSHP-së në kontekstin e DHBGJ është ndërlidhja me rrjetin më të gjerë të shërbimeve.
Referimi efektiv përfshin:

- orientimin e të mbijetuarve drejt shërbimeve të shëndetit mendor;
- bashkëpunimin me strehimore dhe shërbime ligjore;
- përfshirjen në mekanizma të referimit të institucionalizuar dhe të dokumentuar.

Sipas UNFPA, krijimi i modeleve të integruara të ofrimit të shërbimeve është thelbësor për t'i ofruar të mbijetuarve mbështetje të plotë dhe të koordinuar.

Aksesueshmëria dhe lidhja me komunitetin
Qendrat e KSHP-së janë shpesh më të pranishme dhe më të afërta me komunitetin, duke qenë një portë e rëndësishme për ata që përndryshe do ta kishin të pamundur të kërkonin ndihmë.
Aksesueshmëria gjeografike, njohja lokale dhe lidhja sociale e qendrave shëndetësore me komunitetin krijojnë një mjedis të favorshëm për ndërhyrje të hershme dhe për mbështetje të vazhdueshme.
FIGO nënvizon rëndësinë e fuqizimit të qendrave të kujdesit shëndetësor në zonat rurale apo të margjinalizuara, për të garantuar që ndihma dhe kujdesi për DHBGJ të jenë të disponueshme për të gjitha gratë dhe vajzat – pa përjashtim.

Informacion në lidhje me manualin për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore në Kujdesin Parësor Shëndetësor

Manuali për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore në Kujdesin Parësor Shëndetësor
Ky manual është hartuar si një udhëzues praktik për të standardizuar reagimin institucional dhe profesional ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) brenda sistemit të kujdesit shëndetësor parësor. Ai synon të pajisë të gjithë punonjësit e këtij niveli shëndetësor me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të siguruar një përgjigje të menjëhershme, të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të viktimave, në përputhje me mandatin dhe kompetencat ligjore të institucioneve shëndetësore.

Qëllimi i manualit është të mbështesë profesionistët e kujdesit parësor në:

- identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës,
- trajtimin klinik dhe psiko-social të të mbijetuarve,
- garantimin e konfidencialitetit,
- dokumentimin korrekt të rasteve,
- referimin e koordinuar drejt shërbimeve të tjera specializuese.

Manuali përfshin përkufizimet themelore të dhunës me bazë gjinore, format e saj të shfaqjes, bazën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave, si dhe udhëzime praktike për ndërhyrje dhe menaxhim të rasteve nga perspektiva mjekësore dhe sociale.

Struktura e Manualit

Seksioni I – Dhuna me bazë gjinore: konceptet themelore. Ky seksion ofron një hyrje në përkufizimin e DHBGJ-së, kuadrin ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar, format e dhunës, ndikimin e saj në shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe fëmijëve, si dhe rolin e sistemit shëndetësor në adresimin e këtij fenomeni.

Seksioni II – Identifikimi i dhunës me bazë gjinore. Në këtë seksion paraqiten metodat e identifikimit të dhunës në praktikën e përditshme shëndetësore, përfshirë depistimin universal dhe selektiv, shenjat klinike dhe simptomat e mundshme të DHBGJ, barrierat në sistemin shëndetësor, si dhe teknikat për realizimin e intervistave me viktimat në mënyrë etike dhe të ndjeshme.

Seksioni III – Dokumentimi i dhunës me bazë gjinore. Ky seksion nënvizon rëndësinë e dokumentimit të saktë dhe të sigurt të rasteve, duke përfshirë: regjistrimin e lëndimeve, përdorimin e fotografive, ruajtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së pacientit, si dhe rëndësinë e ekzaminimeve mjeko-ligjore për sigurimin e provave që mund të përdoren në procedura gjyqësore.

Seksioni IV – Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i sigurisë. Ky seksion udhëzon profesionistët në vlerësimin e rrezikut për viktimat dhe në hartimin e një plani sigurie që synon mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së tyre, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe sipas udhëzimeve të ligjit.

Seksioni V – Rrugët e referimit dhe bashkëpunimi ndërsektorial. Përshkruhet mekanizmi i referimit ndërinstitucional, përfshirë shërbimet sociale, policinë, sistemin e drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile. Seksioni thekson rëndësinë e bashkëpunimit të strukturuar dhe ndarjes së përgjegjësive për të siguruar një mbështetje të plotë dhe të koordinuar për viktimat.

Seksioni VI – Aspektet etike dhe komunikimi me viktimat. Ky seksion fokusohet në parimet etike gjatë punës me viktimat e DHBGJ, duke përfshirë respektin, konfidencialitetin, mosdiskriminimin dhe miratimin e informuar. Gjithashtu ofron udhëzime për komunikim empatik, të ndjeshëm dhe jo-gjykues, për të ndërtuar besim dhe siguri emocionale në marrëdhënien pacient-profesionist.

Seksioni VII – Trajtimi i grupeve në rrezik të shtuar. Ky seksion trajton qasjet e diferencuara për grupe vulnerabël, përfshirë gratë shtatzëna, fëmijët dhe adoleshentët, personat me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet romë dhe egjiptianë, dhe migrante pa dokumente. Ai ofron shembuj praktikë dhe udhëzime të përshtatura për trajtim dhe referim në përputhje me nevojat e tyre specifike.

Seksioni VIII – Ndjekja dhe monitorimi i rasteve të referuara. Ky seksion përshkruan mënyrën e ndjekjes së rasteve pas referimit, pa cënuar konfidencialitetin. Ai ofron udhëzime për

monitorimin e progresit të viktimës dhe për përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet partnere, si dhe për mbledhjen e të dhënave për qëllime raportimi dhe përmirësimi të shërbimeve.

Seksioni IX – Trajnimi dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm. Seksioni thekson rëndësinë e edukimit të vazhduar për profesionistët shëndetësorë në fushën e DHBGJ. Përfshin rekomandime për trajnime periodike, përfshirjen e tematikës në programet formuese dhe identifikimin e rolit të personelit kyç si koordinatorë institucionalë për menaxhimin e rasteve.

Seksioni X – Menaxhimi i stresit dhe mirëqenies së stafit shëndetësor. Ky seksion adreson ndikimin emocional të punës me raste të dhunës, lodhjen profesionale dhe rrezikun e "burnout"-it. Ofron teknika për menaxhimin e stresit dhe sugjerime për mbështetje institucionale ndaj stafit, për të ruajtur mirëqenien dhe kapacitetin e tyre profesional.

Seksioni XI – Zbatimi i protokolleve dhe standardeve institucionale. Ky seksion përqendrohet në nevojën për zhvillimin dhe zbatimin e protokolleve të brendshme për menaxhimin e DHBGJ në qendrat shëndetësore, në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai udhëzon institucionet në monitorimin e cilësisë së shërbimeve, përfshirjen e drejtuesve institucionalë dhe raportimin efektiv.

Ky manual synon të forcojë rolin e kujdesit shëndetësor parësor si një hallkë kyçe në përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore. Duke fuqizuar mjekët, infermierët dhe të gjithë profesionistët shëndetësorë me njohuritë dhe burimet e nevojshme, ai kontribuon në ndërtimin e një sistemi shëndetësor më të ndjeshëm, të përgjegjshëm dhe të orientuar drejt barazisë dhe të drejtave të njeriut.

Seksioni I – Dhuna me bazë gjinore: konceptet themelore

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) përkufizohet si çdo akt dhune që ushtrohet ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij/saj, që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike. DHBGJ është rrënjosur në marrëdhënie të pabarabarta pushteti ndërmjet grave dhe burrave dhe shfaqet si një formë diskriminimi sistemik.
Sipas legjislacionit shqiptar dhe instrumenteve ndërkombëtare, DHBGJ përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe një çështje madhore e shëndetit publik. Kuadri ndërkombëtar thekson nevojën për një reagim gjithëpërfshirës ndaj kësaj dhune, përmes katër shtyllave të ndërhyrjes: parandalim, mbrojtje, ndjekje penale, dhe politika dhe shërbime mbështetëse.

Korniza dhe instrumentet ndërkombëtare
a) Kombet e Bashkuara (OKB)

- **Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993).** Kjo Deklaratë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së jep një përkufizim gjithëpërfshirës të DHBGJ si çdo akt që rezulton ose mund të rezultojë në dëmtime fizike, seksuale apo psikologjike ndaj grave, duke përfshirë kërcënimet, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë.
- **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË, 1979)** CEDAË e njeh dhunën me bazë gjinore si një formë diskriminimi.
    - Neni 1 përcakton diskriminimin si çdo veprim që kufizon njohjen apo ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore nga gratë.

- Neni 6 u bën thirrje shteteve të luftojnë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual.

Rezoluta 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (2000)
Nënvizon rëndësinë e përfshirjes së grave në proceset e paqes dhe adreson mbrojtjen e tyre nga dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore në situata konflikti.

- **UNICEF -**Përqendrohet në mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve nga DHBGJ, veçanërisht nga martesa e detyruar, shfrytëzimi seksual dhe dhuna në zonat e konfliktit.

b) Këshilli i Evropës – Konventa e Stambollit (2011). Konventa e Stambollit [1] është instrumenti i parë ligjërisht i detyrueshëm në Evropë për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Përcakton DHBGJ si dhunë që drejtohet ndaj një personi për shkak të gjinisë, përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike.
Vendos standarde të detyrueshme për shtetet:

- Parandalim: përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe ndryshimit të normave sociale.
- Mbrojtje dhe mbështetje: për viktimat, përfshirë qasje në shërbime mjekësore dhe psikologjike.
- Ndjekje penale: për autorët e dhunës.
- Koordinim institucional: përmes qasjeve shumëdisiplinore dhe trajnimit të profesionistëve.

c) Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). OBSH njeh DHBGJ[2] si një krizë të shëndetit publik me ndikim afatgjatë në shëndetin fizik, mendor dhe riprodhues të viktimave.
Përkufizimi i OBSH-së: DHBGJ është dhunë e drejtuar ndaj një personi për shkak të gjinisë, me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat. OBSH evidenton pasoja si:

- plagë fizike dhe lëndime kronike,
- depresion, ankth, PTSD,
- shtatzëni të padëshiruara dhe infeksione seksualisht të transmetueshme.

Qasja e saj thekson:

- integrimin e trajtimit të DHBGJ në sistemin shëndetësor,
- trajnimin e profesionistëve shëndetësorë,
- ofrimin e mbështetjes së specializuar për të mbijetuarit.

d) Bashkimi Evropian (BE). Direktiva 2012/29/BE për të drejtat e viktimave
Siguron që viktimat e DHBGJ të kenë akses në mbështetje psikologjike, ligjore dhe masa mbrojtëse. Shtetet anëtare kanë detyrimin të garantojnë ndihmë juridike dhe qasje në mekanizma të mbrojtjes.

Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.

- Neni 21 ndalon diskriminimin mbi bazën e gjinisë.
- Neni 23 nxit barazinë mes grave dhe burrave në të gjitha fushat dhe përfshin mbrojtjen nga DHBGJ.

---

[1] https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention
[2] https://www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/9789241564625/en/

e) Instrumente dhe institucione të tjera ndërkombëtare

- Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC)
- Statuti i Romës e klasifikon dhunën seksuale gjatë konflikteve si krim lufte dhe krim kundër njerëzimit. Ai përfshin përdhunimin, prostitucionin e detyruar dhe forma të tjera të dhunës gjinore si akte të dënueshme penalisht në të drejtën ndërkombëtare.
- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). ILO adreson dhunën dhe ngacmimin seksual në vendin e punës si shkelje të rëndë të të drejtës për punë në kushte të sigurta dhe dinjitoze, duke theksuar përgjegjësinë institucionale për të mbrojtur punëtorët nga DHBGJ.

Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe ai kombëtar njohin DHBGJ si një fenomen kompleks që kërkon një reagim të shumëanshëm dhe të koordinuar. Profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor luajnë një rol kyç në zbatimin e këtyre standardeve dhe në garantimin e një përgjigjeje efektive, humane dhe ligjërisht të përshtatshme për të mbijetuarit.

Përkufizimi i dhunës me bazë gjinore në Shqipëri

Në Shqipëri, kuadri ligjor për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje mbështetet në Ligjin nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", si dhe në dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Ligji nr. 11/2026 zëvendëson Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar. Ligji nr. 11/2026 përcakton masat për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke parashikuar një përgjigje të koordinuar ndërinstitucionale, me në qendër viktimën. Ai synon garantimin e mbrojtjes së menjëhershme, aksesit në shërbime të përgjithshme dhe të specializuara, si dhe parandalimin e viktimizimit të përsëritur.

Përkufizime kyçe sipas Ligjit nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje":

- "Dhunë" është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik.
- "Dhunë ndaj grave" është çdo akt dhune i drejtuar kundër një gruaje ose vajze, përfshirë dhunën gjinore kundër grave dhe që prek gratë e vajzat në mënyrë disproporcionale dhe është një formë diskriminimi që sjell ose ka gjasa të sjellë dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, shtrëngimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike, private, përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia.
- "Dhunë në familje" është çdo akt dhune sipas shkronjës "c" të kësaj pike, ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji, që ndodh brenda ose jashtë njësisë së banimit mes pjesëtarëve që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare për shkaqe natyrore ose juridike, sipas përcaktimeve të këtij ligji, dhe pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.
- "Dhunues" është personi ndaj të cilit është paraqitur përpara organeve përgjegjëse një ankesë, padi ose është person i dyshuar.
- "Viktimë" është çdo person mbi të cilin është ushtruar një nga format e dhunës, sipas përcaktimit në shkronjën "c" të kësaj pike, përfshirë fëmijët dëshmitarë.

- “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri I lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe, sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

Kuadri ligjor kombëtar plotësohet nga Ligji nr. 64/2025, “Për barazinë gjinore”, i cili zëvendëson Ligjin nr. 9970/2008 dhe forcon detyrimet për garantimin e barazisë gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat, programet dhe shërbimet publike. Në sektorin shëndetësor, zbatimi i këtyre parimeve kontribuon në ofrimin e shërbimeve të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe pa diskriminim.

Pjesëtarët e familjes (sipas nenit 12, pika 2, të Ligjit nr. 11/2026)
Subjektet e mbrojtura nga dhuna në familje si pjesëtarë të familjes janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëshorti/ja apo ish-bashkëjetuesi/ja;
b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre;
c) ungji dhe emta dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave, nëse janë anëtarë të njësisë së banimit;
d) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nga birësimi;
e) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë të bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nga birësimi;
f) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es nëse janë anëtarë të njësisë së banimit;
g) personat të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;
h) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi fëmijët e të kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara dhe personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.

Përkufizim shtesë: “Marrëdhënie intime”: “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin intimitet fizik, seksual ose emocional.

Ky kuadër ligjor vendos bazat për një qasje institucionale të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj rasteve të dhunës në familje, duke forcuar rolin e shërbimeve shëndetësore në parandalim, identifikim dhe mbështetje për viktimat. Për profesionistët e kujdesit shëndetësor parësor, njohja e këtyre përkufizimeve është thelbësore për të ofruar ndërhyrje të duhura dhe të bazuara në ligj.

Format e Dhunës me Bazë Gjinore

Dhuna fizike	Forca fizike që rezulton në lëndim trupor, dhimbje ose dëmtim. Ashpërsia e lëndimit varion nga dëmtimi minimal i indeve dhe kockat e thyera, deri te lëndimet e përhershme dhe vdekjen.

	Aktet e dhunës fizike përfshijnë: • Goditje me shuplakë, shtytje, grusht, rrahje, gërvishtje, mbytje, kafshim, kapje, lëkundje, pështyrë, djegie, përdredhje e një pjese të trupit, detyrim per gëlltitjen e një lënde të padëshiruar. • Përdorimi i sendeve shtëpiake për të goditur ose goditur me thikë një grua, duke përdorur armë (thika, armë)
Dhuna seksuale	Çdo akt seksual, përpjekje për të përfituar një akt seksual, akte për trafikim, ose të drejtuara ndryshe kundër seksualitetit të një personi, duke përdorur shtrëngim, nga çdo person, pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shtëpi dhe në punë. Aktet e dhunës seksuale mund të përfshijnë: • Përdhunimi, ose forma të tjera të sulmit seksual • Përparime të padëshiruara seksuale ose ngacmime seksuale (përfshirë kërkesat për seks me ndryshim për promovim ose avancim në punë ose nota të shkollës së lartë) • Trafikim për qëllime shfrytëzimi seksual • Ekspozimi i detyruar ndaj pornografisë • Shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar, aborti i detyruar • Martesa e detyruar, martesa e hershme/fëmijë • Gjymtimi gjenital femëror • Testimi i virgjërisë • Incesti
Dhuna psikologjike	Dhuna psikologjike (dhuna emocionale) Një veprim ose grup veprimesh që dëmtojnë drejtpërdrejt integritetin psikologjik të gruas si ërcënimet, fyerjet, intimidimi, manipulimi emocional, kontrolli dhe shpërfillja e viktimës. Aktet e dhunës psikologjike përfshijnë: • Kërcënimet për dhunë dhe lëndime ndaj gruas ose dikujt afër saj, nëpërmjet fjalë ose veprime (p.sh. përmes përndjekjes ose shfaqjes së armëve) • Ngacmimi në vendin e punës • Komentet poshtëruese dhe fyese • Izolimi dhe kufizimet në komunikim • Përdorimi i fëmijëve nga një partner intim i dhunshëm për të kontrolluar ose lënduar gruan. Këto akte përbëjnë të dyja, dhunën ndaj fëmijëve, si dhe dhunën ndaj grave

Dhuna ekonomike	Dhuna ekonomike Përdoret për të mohuar dhe kontrolluar aksesin e një gruaje në burime, duke përfshirë kohën, paratë, transporti, ushqimi ose veshmbathja. Aktet e dhunës ekonomike përfshijnë: • Ndalimi i punës së gruas • Përjashtimi i saj nga vendimmarrja financiare në familje • Mbajtja e parave ose informacioni financiar • Refuzimi për të paguar faturat ose mirëmbajtjen për të ose për fëmijët • Shkatërrimi i aseteve në pronësi të përbashkët

Dhuna digjitale	Dhuna që ndodh në mjedisin virtual dhe përdor teknologjinë dhe internetin për të ushtruar dhunë ndaj viktimave. Akte të dhunës virtuale përfshijne: • Ngacmimi dhe shantazhi nëpërmjet rrjeteve sociale, • shpërndarja e fotove intime pa pëlqimin e viktimës (revenge porn), • Përndjekja online (cyberstalking).

Të kuptuarit e dinamikës së dhunës në marrëdhëniet intime

Dhuna në marrëdhëniet intime, e njohur shpesh si Dhuna nga Partneri Intim (DHPI), përbën një problem serioz të shëndetit publik dhe një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Ajo prek individë në të gjitha shtresat e shoqërisë dhe në të gjitha kulturat. DHPI nuk shfaqet vetëm në formën e dhunës fizike, por përfshin gjithashtu edhe forma të tjera të abuzimit, si ai psikologjik, seksual dhe ekonomik. Këto forma dhune nuk janë ngjarje të izoluara, por ndjekin një model të përsëritur të kontrollit dhe dominimit, ku abuzuesi përdor një sërë taktikash për të ushtruar pushtet ndaj partnerit. Të kuptuarit e kësaj dinamike është thelbësor për të zhvilluar ndërhyrje efektive për parandalimin dhe trajtimin e saj.

Dhunës fizike i referohemi kur kemi të bëjmë me përdorim force që rezulton në lëndim trupor, si goditje, shuplaka, shkelma apo mbytje. Kjo formë është shpesh më e dukshmja, por jo domosdoshmërisht më e rënda, pasi edhe format jo fizike të dhunës kanë pasoja të thella afatgjata për viktimën (World Health Organization 2017). Dhuna psikologjike dhe emocionale përfshin sjellje që synojnë të dëmtojnë mirëqenien mendore të viktimës, siç janë fyerjet, poshtërimi publik ose privat, kërcënimet, frikësimi dhe kontrolli emocional. Këto taktika përdoren për të minuar vetëvlerësimin dhe ndjenjën e pavarësisë së viktimës, duke krijuar një ndjenjë të vazhdueshme ankthi dhe pasigurie (Dutton 2006).

Dhunës seksuale i referohemi kur ka përfshirje në akte seksuale pa pëlqimin e plotë dhe të informuar të partnerit. Kjo mund të përfshijë përdhunimin, detyrimin për akte seksuale, apo prekjet e padëshiruara. Shpeshherë, në marrëdhënie të dhunshme, dhuna seksuale përdoret si një mjet shtesë për të ruajtur kontrollin dhe për të nënshtruar partnerin (Rothman et al. 2011). Ndërsa dhuna ekonomike nënkupton kontrollin mbi burimet financiare të viktimës, përmes kufizimit të aksesit në para, ndalimit për të punuar, ose menaxhimit të plotë të të ardhurave nga ana e abuzuesit. Kjo formë e bën viktimën plotësisht të varur ekonomikisht dhe e pengon të largohet nga marrëdhënia abuzive (Adams 2007).

Në zemër të DHPI qëndron dinamika e pushtetit dhe kontrollit. Abuzuesi synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dominimi, ku viktima ndjehet gjithnjë e më e paaftë për të vepruar në mënyrë të pavarur. Kjo realizohet përmes disa taktikave të përsëritura. Izolimi është një prej tyre: abuzuesi synon të largojë viktimën nga rrjeti i saj i mbështetjes – familja, miqtë apo kolegët – për ta bërë më të varur emocionalisht dhe praktikisht. Një tjetër taktikë është kërcënimi, që mund të përfshijë paralajmërime për dëmtim fizik, vetëvrasje, apo dënime sociale apo ligjore, që i përdor për ta frikësuar dhe kontrolluar viktimën.

Manipulimi psikologjik është gjithashtu një strategji e zakonshme: ai synon të bëjë viktimën të dyshojë në perceptimet dhe kujtesën e saj, një fenomen i njohur si "gaslighting" (Walker 2017). Më tej, abuzuesi shpesh përdor taktika fajësimi dhe minimizimi, duke ia transferuar përgjegjësinë për dhunën vetë viktimës, ose duke e mohuar ose zvogëluar rëndësinë e veprimeve të tij, në mënyrë që të shmangë përgjegjësinë (Stark 2007).
Njohja e këtyre modeleve është esenciale për profesionistët që punojnë në fushën e shëndetit, drejtësisë, apo mbrojtjes sociale, në mënyrë që të ndihmojnë më mirë viktimat, të parandalojnë përshkallëzimin e dhunës dhe të ndërtojnë sisteme efektive mbrojtjeje.

"Modeli i Rrotës së Fuqisë dhe Kontrollit", i zhvilluar nga Pence dhe Paymar (1993), paraqet në mënyrë të qartë dhe vizuale mënyrat sistematike përmes të cilave abuzuesit ushtrojnë dominim dhe kontroll në marrëdhëniet intime. Ky model ndihmon në identifikimin e taktikave të zakonshme të dhunës jo-fizike, duke përfshirë frikësimin, izolimin, manipulimin emocional dhe kontrollin ekonomik, të cilat shërbejnë për të mbajtur nënshtrimin dhe varësinë e viktimës."

Më poshtë paraqitet **Grafika e Rrotës së Fuqisë dhe Kontrollit** sipas Modelit të Pence & Paymar (1993), një vizualizim shumë i dobishëm për të kuptuar taktikat sistematike të përdorura nga abuzuesit për të ruajtur dominimin në marrëdhëniet intime. Kjo rrotë tregon në brendësi të saj sjelljet insidioze (p.sh., izolim, manipulim, fajësim), të cilat mbështeten nga dhuna fizike e seksuale në konturin e jashtëm. Nw librin e tyre pwrshkruhet në detaje **Modeli i Duluth-it** dhe përmban **"Rrotën e Fuqisë dhe Kontrollit"**, një mjet i njohur ndërkombëtarisht për analizën e dinamikës së dhunës në marrëdhëniet intime.



Cikli i dhunës

Dhuna në marrëdhëniet intime nuk është një ngjarje e vetme, por shpesh ndodh në një model të përsëritur, i njohur si cikli i dhunës. Ky model ndihmon në kuptimin e mënyrës se si dhuna normalizohet dhe vazhdon brenda marrëdhënies. Fillimisht, tensionet rriten gradualisht – partneri dhunues shfaq nervozizëm, xhelozi ose sjellje kontrolluese, që mund të shoqërohen me incidente të vogla agresioni verbal apo emocional. Më pas ndodh shpërthimi i dhunës: agresioni bëhet i hapur dhe shpesh përfshin veprime fizike, fyerje të rënda, ose abuzim seksual. Pas këtij shpërthimi, shpesh ndodh një periudhë qetësie e njohur si "muaji i mjaltit", ku abuzuesi kërkon falje, premton ndryshim dhe përpiqet të rikthejë besimin e viktimës. Kjo periudhë mund të sjellë konfuzion emocional dhe ta bëjë më të vështirë largimin nga marrëdhënia (Walker 1979).

Ky model i ciklit e mban viktimën të bllokuar në një marrëdhënie që përsëritet mes dhunës dhe pajtimit të rremë, duke krijuar një ambient emocionalisht të paqëndrueshëm dhe duke e dobësuar aftësinë për të kërkuar ndihmë ose për të ndërmarrë hapa për t'u shkëputur.

Shkaqet dhe faktorët nxitës të dhunës

Shumë faktorë ndërveprojnë për të krijuar dhe ushqyer dhunën në marrëdhëniet intime. Një ndër më të rëndësishmit është ndikimi i normave shoqërore që legjitimojnë pabarazinë gjinore dhe fuqizojnë rolet tradicionale ku burri shihet si autoriteti i familjes. Në këto kontekste, dhuna nga partneri mund të shihet si "normale" ose e justifikuar (Heise 1998).

Gjithashtu, përdorimi i substancave si alkooli dhe drogat lidhet shpesh me rritjen e dhunës, duke ndikuar negativisht në aftësinë për të kontrolluar impulset dhe në reagimet emocionale të dhunuesit (Foran and O'Leary 2008). Një tjetër faktor i rëndësishëm është historia e traumës personale – individët që janë rritur në mjedise ku dhuna ka qenë e pranishme kanë më shumë gjasa të përfshihen në marrëdhënie të ngjashme në të ardhmen, si autorë apo si viktima (Widom 1989).
Çrregullimet mendore gjithashtu mund të ndërlikojnë sjelljet e dhunshme. Edhe pse nuk janë shkak i drejtpërdrejtë i dhunës, disa gjendje psikologjike si depresioni i rëndë, çrregullimet e personalitetit apo ankthi i pakontrolluar mund të ndikojnë negativisht në mënyrën se si individi përballet me konfliktin (Dutton 2006).

Pasojat e dhunës ndaj viktimës

Dhuna e vazhdueshme ka efekte të thella dhe komplekse në jetën e viktimave, që përfshijnë dëmtimin fizik, psikologjik dhe shoqëror. Nga ana fizike, viktimat mund të pësojnë dëmtime që variojnë nga mavijosjet deri te lëndimet serioze si fraktura, goditje në kokë apo dëmtime të organeve të brendshme (Campbell et al. 2002). Por efektet më të rënda shpesh nuk janë të dukshme: shumë viktima përjetojnë ndjenja të forta frike, ankthi, depresioni të thellë dhe çrregullime post-traumatike, duke u ndier të pafuqishme dhe pa kontroll mbi jetën e tyre (Golding 1999).
Izolimi shoqëror është një tjetër pasojë e zakonshme, pasi dhunuesit synojnë të shkëpusin viktimën nga rrjetet e mbështetjes si familja, miqtë apo komuniteti, për të rritur varësinë dhe për të penguar kërkimin e ndihmës (Humphreys and Thiara 2003). Me kalimin e kohës, trauma e pashëruar dhe stresi kronik ndikojnë gjithashtu në shëndetin fizik të viktimës, duke kontribuar në sëmundje të rënda si ato kardiovaskulare, çrregullime të tretjes dhe dhimbje të vazhdueshme pa shpjegim të qartë mjekësor (Campbell 2002).

Thyerja e ciklit të dhunës

Strategjitë për ndërprerjen e ciklit të dhunës

Pavarësisht kompleksitetit të dhunës në marrëdhëniet intime, ekzistojnë mënyra efektive për të ndërhyrë dhe thyer ciklin e abuzimit. Një nga hapat e parë më të rëndësishëm është **kërkimi i mbështetjes** nga individë të besuar – si anëtarë të familjes, miq të afërt – ose nga struktura profesionale si strehimoret, shërbimet ligjore dhe ato të këshillimit psikologjik (Lacey et al. 2010). Këto rrjete ndihmojnë në rivendosjen e ndjenjës së sigurisë dhe vetëvlerësimit tek të mbijetuarit.

Terapia dhe këshillimi psikologjik janë gjithashtu thelbësore për të mbështetur jo vetëm viktimat, por edhe autorët e dhunës në procesin e përballjes me traumat, konfliktet e brendshme dhe modelet e mësuara të sjelljes. Trajtimet afatgjata, të orientuara drejt ndërgjegjësimit dhe ndryshimit të sjelljes, mund të luajnë rol kyç në ndërprerjen e dhunës (Stark 2007).

Nga ana tjetër, **mekanizmat ligjorë mbrojtës**, si urdhrat e ndalimit dhe ndjekja penale e abuzuesve, janë mjete thelbësore për të siguruar mbrojtje dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës (Sullivan and Rumptz 1994). Së fundmi, **programet e edukimit publik dhe fushatat ndërgjegjësuese**, që promovojnë barazinë gjinore dhe marrëdhëniet e shëndetshme, luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e normave shoqërore që ushqejnë dhunën (Heise 1998).

Seksioni II – Identifikimi i dhunës me bazë gjinore.

Edhe pse të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) kanë më shumë gjasa sesa popullata e përgjithshme të përdorin shërbime shëndetësore, ata rrallëherë e zbulojnë në mënyrë spontane përvojën e dhunës. Shumë shpesh, ndrojtja, frika nga stigmën, mungesa e besimit ose kontrolli që ushtron abuzuesi e pengojnë këtë hap. Në këto kushte, roli i profesionistëve të kujdesit shëndetësor bëhet vendimtar: kur ata pyesin me kujdes, ndjeshmëri dhe respekt për konfidencialitetin nëse pacienti mund të jetë i ekspozuar ndaj dhunës, shanset për zbulimin e rasteve të DHBGJ rriten ndjeshëm. Ky akt përbën një pikënisje të rëndësishme për çdo ndërhyrje mbështetëse apo terapeutike.

Depistimi Universal

Ekzaminimi universal nënkupton pyetjen sistematike dhe proaktive të të gjithë pacientëve – pavarësisht nëse shfaqin apo jo shenja të dukshme të dhunës – për përvojat e mundshme me DHBGJ. Kjo qasje përdoret shpesh në kujdesin parësor, vizitat rutinë, konsultat për probleme të reja shëndetësore, takimet me pacientë të rinj, apo gjatë seancave të këshillimit. Të gjithë pacientëve u drejtohet një grup pyetjesh të njëjta dhe të standardizuara lidhur me ekspozimin ndaj dhunës.

Qëllimi i ekzaminimit universal është të zbulojë rastet e fshehura të dhunës në një mjedis të sigurt dhe jo-gjykues, duke u dhënë të mbijetuarve mundësinë të flasin për përvojat e tyre pa presion dhe me mbështetje profesionale. Kjo metodë ka natyrë parandaluese dhe fokusohet në zbulimin e hershëm të dhunës, përfshirë edhe rastet ku individi nuk është vetëdijësuar plotësisht për natyrën abuzive të marrëdhënies. Përveç ofrimit të mbështetjes, ekzaminimi universal ndihmon në normalizimin e temës së dhunës në marrëdhëniet intime si një çështje e rëndësishme për shëndetin publik, jo si një tabu që duhet shmangur.

Depistimi selektiv

Në kontrast me ekzaminimin universal, **depistimi selektiv** i referohet pyetjes vetëm ndaj atyre pacientëve që shfaqin shenja të dukshme, simptoma të dyshimta ose faktorë rreziku të njohur për dhunë me bazë gjinore. Kjo metodë përdor një qasje të orientuar, ku profesionistët e kujdesit shëndetësor vendosin të pyesin për DHBGJ vetëm kur ka indikacione klinike ose psikologjike që mund të sugjerojnë një histori abuzimi.

Faktorët që mund të nxisin një depistim selektiv përfshijnë: lëndime të përsëritura ose të paqarta, vonesa në kërkimin e ndihmës për dëmtime të rënda, simptoma kronike të stresit, ankthit ose depresionit pa shkak të qartë mjekësor, si dhe prezenca e një partneri mbizotërues gjatë konsultës mjekësore. Në këto raste, profesionistët mund të fillojnë një bisedë të ndjeshme duke përdorur pyetje të hapura dhe gjuhë jo-gjykues për të eksploruar nëse pacienti ndodhet në një marrëdhënie të pasigurt ose abuzive.

Kjo metodë është më e përqendruar dhe kërkon më pak burime njerëzore dhe kohë sesa ekzaminimi universal. Megjithatë, ajo ka edhe kufizimet e saj: në shumë raste, të mbijetuarit nuk shfaqin simptoma të dukshme ose nuk janë të gatshëm të flasin për përvojat e tyre, çka mund të çojë në nën-identifikim të dhunës. Për këtë arsye, shumë ekspertë të shëndetit publik rekomandojnë një kombinim të të dyja metodave në varësi të kontekstit, burimeve në dispozicion dhe nivelit të trajnimit të stafit.

Pavarësisht se cila qasje zgjidhet – universale apo selektive – thelbësore mbetet **trajnimi i personelit shëndetësor** në ofrimin e pyetjeve me ndjeshmëri, ruajtjen e konfidencialitetit dhe ndjekjen e protokolleve të referimit. Një mjedis i sigurt, jo-gjykues dhe mbështetës, ku

pacientët ndihen të dëgjuar dhe të respektuar, është parakusht për çdo zbulim dhe ndërhyrje të suksesshme në rastet e DHBGJ.

Tabela 1. Krahasimi ndërmjet ekzaminimit universal dhe depistimit selektiv

Aspekti	**Ekzaminimi universal**	**Depistimi selektiv**
Përkufizimi	Pyetja sistematike e të gjithë pacientëve, pavarësisht shenjave të dukshme të dhunës.	Pyetja vetëm ndaj pacientëve që shfaqin shenja, simptoma ose faktorë rreziku.
Qëllimi	Zbulimi i hershëm i rasteve të fshehura dhe normalizimi i temës së DHBGJ në kujdesin shëndetësor.	Identifikimi i DHBGJ kur ka indikacione të qarta klinike ose kontekstuale.
Zbatimi	Gjatë vizitave rutinë, konsultave fillestare, takimeve me pacientë të rinj, etj.	Vetëm kur ka sinjale shqetësuese, si lëndime të përsëritura ose sjellje të dyshimta.
Përfitimet	Rrit identifikimin e rasteve të fshehura; promovon ndërgjegjësim dhe parandalim.	Kursen kohë dhe burime; fokus i drejtpërdrejtë në rastet më të dukshme.
Kufizimet	Kërkon trajnim të personelit dhe më shumë kohë; mund të mos jetë i realizueshëm në të gjitha kontekstet.	Rrezikon të mos zbulojë rastet pa simptoma të dukshme; varet shumë nga perceptimi i stafit.
Roli i stafit shëndetësor	Iniciator aktiv; kërkon ndjeshmëri, njohuri dhe standardizim të pyetjeve.	Vëzhgues reaktiv; kërkon gjykim klinik dhe njohje të shenjave të mundshme të dhunës.
Përputhshmëria me protokollet	Promovohet në mjedise me politika gjithëpërfshirëse për DHBGJ.	Përdoret më shpesh në sisteme me burime të kufizuara ose mungesë protokollesh kombëtare.

Parimet për profesionistët e shëndetësisë gjatë ekzaminimit për DHBGJ

Për të siguruar që ekzaminimi për DHBGJ të jetë i sigurt, etik dhe efektiv, punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet të udhëhiqen nga disa parime thelbësore:

- Trajnimi dhe ndjeshmëria kulturore: Stafi duhet të jetë i pajisur me njohuri mbi format e dhunës, ndikimin e saj dhe mënyrat e identifikimit, duke treguar gjithmonë respekt për sfondin kulturor dhe përvojat individuale të pacientëve.
- Ruajtja e besueshmërisë dhe konfidencialitetit: Informacioni i marrë duhet të trajtohet me kujdes maksimal, duke respektuar privatësinë dhe konfidencialitetin e pacientit. Informacioni mund të ndahet me autoritetet përgjegjëse në përputhje me detyrimet ligjore për raportimin e dhunës. Sipas nenit 14 të Ligjit nr. 11/2026, transmetimi i të dhënave mund të bëhet edhe pa pëlqimin e viktimës, kur ekzistojnë arsye të bazuara për të besuar se ka ndodhur një nga format e dhunës të parashikuara nga ligji ose se ekziston rrezik i menjëhershëm për ushtrimin e saj. Në çdo rast, ndarja e informacionit duhet të respektojë kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Identifikimi i shenjave fizike dhe psikologjike: Lëndimet e pashpjegueshme, mungesa e kontaktit me sy, ndrojtja e tepërt, ose prania e një partneri shumë kontrollues janë sinjale që nuk duhen injoruar.
- Përdorimi i pyetjeve të ndjeshme dhe jo-gjykues: Pyetjet duhet të jenë të hapura, të drejtpërdrejta dhe të bëhen me kujdes, si: "A ndiheni ndonjëherë e pasigurt në marrëdhënien tuaj?" ose "A është dikush që ju kufizon në mënyrën si jetoni apo vendosni?"
- Ofrimi i mbështetjes dhe referimit: Pasi zbulohet një rast i mundshëm, stafi duhet të jetë në gjendje të ofrojë ndihmë të menjëhershme ose të referojë personin në strehimore, shërbime ligjore ose mbështetje psikologjike.

Udhëzime për grupmoshat që i nënshtrohen ekzaminimit për DHBGJ

- Gratë mbi 14 vjeç: Duhet të pyeten për përvojat me dhunën fizike, seksuale dhe emocionale të paktën një herë në vit, gjatë vizitave rutinë shëndetësore në qendër ose në shtëpi.
- Gratë shtatzëna: Duhet të ekzaminohen për DHBGJ gjatë vizitës së parë prenatale, në çdo tremujor të shtatzënisë, dhe gjatë kontrollit pas lindjes brenda 40 ditëve.
- Fëmijët 0–14 vjeç: Në rastet kur fëmija nuk shton në peshë, paraqet trauma të përsëritura pa shpjegim mjekësor ose sjellje të pazakonta, personeli shëndetësor duhet të pyesë prindin apo kujdestarin në mënyrë jo-drejtpërdrejtë për mundësinë e dhunës ose abuzimit.

📌 **Kutiza 1. Depistimi për dhunën në familje – përfshirja në dokumentacionin shëndetësor**

Depistimi për dhunën në familje duhet të jetë i integruar në mënyrë të qëndrueshme në dokumentacionin mjekësor të individit, për të siguruar një identifikim të hershëm dhe ndërhyrje të duhur. Konkretisht:

- ✅ Duhet të jetë pjesë e kartelës personale shëndetësore të individit, ku përfshihet anamneza e plotë shëndetësore.
    - 🔷 *Përdoret: Formulari për Depistimin Rutinë të Dhunës në Familje – Shtojca 1.*
- ✅ Duhet të jetë pjesë e kartelës personale shëndetësore të gruas gjatë vizitave në këshillimore e gruas dhe fëmijës, duke mundësuar vlerësimin sistematik të ekspozimit ndaj dhunës gjatë ciklit jetësor.

📦 **Kutiza 2. Shembull nga praktika ndërkombëtare – Depistimi universal në Suedi**

Suedia ka zbatuar me sukses një model të depistimit universal për dhunën ndaj grave në sistemin e saj të kujdesit shëndetësor publik, si pjesë e përpjekjeve për të parandaluar dhe adresuar dhunën me bazë gjinore.

🔷 Zbatimi: Të gjitha gratë që marrin shërbime në kujdesin parësor, përfshirë vizitat prenatale dhe kontrollet rutinë, pyeten në mënyrë sistematike dhe konfidenciale për përvojat me dhunën, pavarësisht nëse shfaqin apo jo shenja të dhunës.

🔷 Procesi:

- Pyetjet bëhen gjatë vizitës individuale dhe pa praninë e partnerit.
- Formularët mjekësorë përfshijnë pyetjet si pjesë të standardit të anamnezës.

- Profesionistët shëndetësorë janë të trajnuar për ndjeshmëri kulturore dhe menaxhim të rasteve të zbulimit.

🔷 Pyetje të zakonshme:

- "A ndiheni gjithmonë e sigurt në shtëpinë tuaj?"
- "A ka dikush në jetën tuaj që ju frikëson ose kontrollon mënyrën si jetoni?"
- "A ka ndodhur ndonjëherë që dikush t'ju lëndojë fizikisht apo emocionalisht?"

🔷 Rezultati: Kjo qasje ka rritur identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës, ka përmirësuar aksesin në mbështetje dhe ka forcuar rolin e sektorit shëndetësor si pikë kontakti jetike për të mbijetuarit.

Simptomat, Shenjat dhe Sjelljet e Lidhura me Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ)

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) përfshin një spektër të gjerë dëmtimesh fizike, psikologjike, seksuale, emocionale dhe sociale, që ushtrohen ndaj individëve për shkak të gjinisë së tyre. Identifikimi i hershëm i simptomave dhe manifestimeve të kësaj dhune është thelbësor për ofrimin e mbështetjes klinike, mbrojtjes dhe ndërhyrjes së duhur.

Shenjat dhe simptomat fizike

- Lëndime të përsëritura dhe të pashpjegueshme: Mavijosje, gërvishtje, çarje të lëkurës ose plagë në pjesë të ndjeshme të trupit si fytyra, qafa, gjoksi, krahët dhe kofshët.
- Shenja karakteristike të mbajtjes me forcë: Mavijosje në formë gishti në pjesën e sipërme të krahëve ose në qafë.
- Fraktura ose dëmtime kockore: Fraktura në gjymtyrë, brinjë apo kyçe, sidomos nëse raportohen shpesh ose nuk përputhen me rrëfimin e pacientit.
- Djegie me formë të veçantë: Djegie që ngjajnë me objekte (hekur, cigare), të cilat tregojnë abuzim të qëllimshëm.
- Dhimbje kronike pa shkak të identifikueshëm mjekësor: Dhimbje koke të shpeshta, dhimbje shpine, legeni ose barku të lidhura me ekspozimin ndaj dhunës.
- Lëndime në kokë, sy dhe veshë: Mavijosje në kokë, sy të nxirë, daulle të veshit të dëmtuar – shpesh tregues të goditjeve të dhunshme.
- Shenja të mbytjes: Njolla në formë gishti ose petechia (njolla të kuqe të vogla) në qafë dhe fytyrë, që mund të vijnë nga presioni fizik në qafë.
- Infeksione seksualisht të transmetueshme (IST): Mund të jenë pasojë e marrëdhënieve seksuale të detyruara.
- Simptoma gjenitale dhe riprodhuese: Dhimbje të legenit, gjakderdhje vaginale të pashpjegueshme, aborte të përsëritura, infeksione ose dëmtime në zonën gjenitale.

Shenjat dhe simptomat psikologjike dhe emocionale

- Çrregullime të ankthit: Përfshirë sulme paniku, tension të vazhdueshëm dhe frikë të pashpjegueshme.
- Depresion dhe tërheqje sociale: Trishtim i zgjatur, mungesë energjie, humbje interesi në aktivitetet e zakonshme dhe izolim.
- Çrregullim i stresit post-traumatik (PTSD): Kthime të vazhdueshme mendore në përvojat e dhunës (flashbacks), makthe, hipervigjilencë dhe pagjumësi.
- Mpirje emocionale: Shkëputje emocionale si mekanizëm mbrojtës përballë traumës së vazhdueshme.
- Vetëvlerësim i ulët dhe ndjenja faji: Ndjenja se "e meritojnë" dhunën ose mungesë besimi në veten.

- Mendime vetëvrasëse: Në raste të dhunës afatgjatë, individët mund të raportojnë dëshirë për t'i dhënë fund jetës.

Shenjat dhe simptomat seksuale dhe riprodhuese

- Dhimbje ose parehati gjatë marrëdhënieve seksuale: Tregues i traumës seksuale të pashpallur.
- Frikë ose shmangie nga kontakti seksual: Sidomos në marrëdhënie të qëndrueshme, si pasojë e përvojave të mëparshme të dhunës.
- Shtatzëni e paqëllimshme ose aborte të përsëritura: Mund të jenë pasojë e aktivitetit seksual të detyruar apo refuzimit të aksesit në kontracepsion.
- Infeksione ose dëmtime gjenitale: Tregues të dhunës seksuale të vazhdueshme.

Shenjat në sjellje

- Izolim dhe shmangie: Heqja dorë nga marrëdhëniet sociale dhe aktivitetet rutinë, shpesh si rezultat i kontrollit nga partneri.
- Ndryshime në pamje ose sjellje: Veshje që mbulojnë trupin, mungesa të pashpjegueshme nga puna apo shkolla.
- Hipervigjilencë dhe frikë e vazhdueshme: Reagim i ekzagjeruar ndaj zhurmave apo pranishmërisë së papritur të njerëzve.
- Përdorim i substancave psikoaktive: Alkooli ose droga si strategji përballimi ndaj dhunës ose për të përballuar traumën.
- Sjellje agresive ose shpërthyese: Në disa raste, viktimat mund të shfaqin reagime të forta emocionale si pasojë e stresit të akumuluar.
- Nënshtrim i tepërt ose pajtueshmëri: Sjellje të kujdesshme për të shmangur konfrontimin, tregues i kontrollit të brendshëm nga frika.

Shenjat tek fëmijët dëshmitarë të DHBGJ

- Sjellje agresive ose imituese të dhunës: Fëmijët që ekspozohen ndaj dhunës shpesh riprodhojnë sjelljet e dhunshme në lojë ose marrëdhënie me të tjerët.
- Tërheqje emocionale dhe regresion: Sjellje që i përkasin një faze më të hershme zhvillimore (urinim në shtrat, frikëra të papritura, thithje gishti).
- Vështirësi në shkollë: Probleme të përqendrimit, rënie në performancë akademike dhe mungesa të shpeshta.
- Çrregullime emocionale: Ankth, trishtim i vazhdueshëm, ndjenja pasigurie dhe ndarje të fortë nga figura të rëndësishme si nëna.
- Frikë nga braktisja ose humbja: Lidhur me pasigurinë që vjen nga ambienti i dhunshëm në familje.

Kutiza 3. Sjelljet e dhunuesit që mund të sinjalizojnë prani të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ)

Identifikimi i sjelljeve të kontrollit dhe dominimit nga ana e dhunuesit është thelbësor për zbulimin e hershëm të DHBGJ. Sjelljet e mëposhtme mund të shërbejnë si tregues të qartë të një marrëdhënieje abuzive:

- **Sjellje kontrolluese**: Abuzuesi ushtron kontroll mbi lëvizjet, veshjen, komunikimin dhe marrëdhëniet sociale të viktimës. Mund të diktojë se ku mund të shkojë ajo, me kë të ndërveprojë dhe si të sillet në publik.

- **Xhelozi patologjike ose zotërim**: Akuzat e përsëritura për pabesi, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe nevoja për të kontrolluar çdo aspekt të jetës së viktimës janë shenja të abuzimit emocional dhe psikologjik.
- **Sjellje kërcënuese**: Abuzuesi përdor kërcënime të drejtpërdrejta për ushtrim dhune ose kërcënime indirekte përmes frikësimit psikologjik (p.sh. duke kërcënuar se do të dëmtojë të afërmit, fëmijët apo kafshët shtëpiake të viktimës).
- **Izolim**: Dhunuesi përpiqet të shkëpusë viktimën nga rrjetet mbështetëse – familja, miqtë apo kolegët – për ta bërë më të varur dhe të pambrojtur.
- **Fajësim i viktimës**: Viktima vihet vazhdimisht në pozitë përgjegjësie për dhunën e ushtruar, duke u bërë të ndiejë faj ose përgjegjësi për sjelljet e dhunuesit.

Barrierat në sistemin e kujdesit shëndetësor në trajtimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ)

Sistemi i kujdesit shëndetësor luan një rol kyç në identifikimin, trajtimin dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, si të mbijetuarit, ashtu edhe profesionistët e shëndetësisë përballen me pengesa të shumta strukturore, kulturore dhe institucionale që kufizojnë efektivitetin e reagimit ndaj DHBGJ.

Barrierat e përjetuara nga gratë e mbijetuara të DHBGJ në aksesimin e kujdesit shëndetësor

- Frika nga përshkallëzimi i dhunës. Shumë gra shmangin kërkimin e ndihmës mjekësore nga frika se zbulimi i abuzimit do të çojë në hakmarrje nga partneri dhunues, përfshirë rritjen e dhunës ose kontrollit ndaj tyre (Feder et al. 2006).
- Stigma dhe normat kulturore. Turpi, frika nga gjykimi, si dhe pritshmëritë gjinore që minimizojnë ose normalizojnë dhunën në familje, i dekurajojnë gratë të raportojnë abuzimin apo të kërkojnë ndihmë (Heise 1998).
- Varësia ekonomike dhe pasiguria sociale. Mungesa e burimeve financiare, varësia nga abuzuesi për strehim apo të ardhura, si dhe mungesa e sigurimeve shëndetësore, pengojnë aksesin në shërbime (Adams et al. 2007).
- Trauma psikologjike dhe ndjenja faji. Të mbijetuarat shpesh përballen me ndjenja vetëfajësimi, mungesë vetëbesimi dhe çrregullime të shëndetit mendor që ndikojnë në aftësinë për të kërkuar ndihmë (Golding 1999).
- Mungesa e reagimit të ndjeshëm institucional. Përvoja me shërbime jomiqësore, mungesë të konfidencialitetit, ose trajtim gjykues nga profesionistët shëndetësorë shpesh i detyron gratë të heqin dorë nga kërkimi i ndihmës (Hegarty et al. 2007).
- Pengesat juridike dhe burokratike. Proceset ligjore të komplikuara, mungesa e mbrojtjes efektive, si dhe frika nga përfshirja me autoritetet ligjore, pengojnë raportimin e rasteve të dhunës (Sullivan and Rumptz 1994).
- Distanca dhe mungesa e shërbimeve në zonat rurale. Gratë që jetojnë në zona të izoluara shpesh përballen me mungesë të qendrave të specializuara, transport të papërshtatshëm dhe staf të pakualifikuar (Devries et al. 2013).

Barrierat e përjetuara nga profesionistët e shëndetësisë

- **Mungesa e trajnimit dhe njohurive praktike. Shumë profesionistë të shëndetit nuk** kanë përgatitje të mjaftueshme për të identifikuar ose për t'iu përgjigjur rasteve të DHBGJ në mënyrë etike dhe efektive (Colombini et al. 2012).

- Frika për sigurinë e pacientit dhe të vetes. Në disa raste, profesionistët shmangin përfshirjen për shkak të shqetësimeve për përshkallëzimin e dhunës dhe sigurinë e të mbijetuarve ose të tyre personale (Hegarty and Taft 2001).
- Kufizimet kohore dhe ngarkesa klinike. Numri i lartë i pacientëve dhe mungesa e kohës për ekzaminim të plotë e bën të vështirë zhvillimin e dialogut për çështje delikate si dhuna (Feder et al. 2006).
- Normat sociale dhe paragjykimet gjinore. Praktikat kulturore dhe paragjykimet e brendshme të personelit mund të ndikojnë në aftësinë për të dhënë mbështetje të paanshme dhe të ndjeshme (Bacchus et al. 2018).
- Pasiguria ligjore dhe raportimi i detyruar. Mungesa e qartësisë mbi detyrimet ligjore në rastet e raportimit të detyruar mund të pengojë veprimin ose të krijojë konfuzion mbi mbrojtjen e të drejtave të pacientit (World Health Organization 2013).
- Mungesa e infrastrukturës mbështetëse. Për shumë shërbime shëndetësore mungon lidhja me strukturat e mbështetjes si psikologët, strehimoret, ose asistenca ligjore. Kjo pengon ndjekjen e rasteve të identifikuara (Colombini et al. 2012).
- Qasje gjykuese ose nënvlerësuese. Në disa raste, qëndrimet e personelit shëndetësor, përfshirë fajësimin e viktimës ose minimizimin e përvojës së dhunës, krijojnë mjedise të pasigurta për të mbijetuarat (Golding 1999; Hegarty et al. 2007).

Kërkesat dhe standardet për intervistimin e pacientëve mbi DHBGJ

Kërkesa Themelore	**Standardet dhe Kriteret e Zbatimit**	**Qëllimi dhe Rëndësia**
Konfidencialiteti dhe Privatësia	Siguroni një ambient të mbyllur, të qetë dhe pa prani të palëve të treta, ku biseda mund të zhvillohet pa ndërprerje apo frikë nga dëgjimi.	Krijon një atmosferë sigurie dhe besimi, duke minimizuar frikën nga hakmarrja apo stigmatizimi.
Qasje e ndjeshme ndaj traumës (Trauma-Informed)	Punonjësit duhet të demonstrojnë ndjeshmëri emocionale dhe të pranojnë reagimet e pacientit pa paragjykim, duke i ofruar atij kontroll mbi ritmin e bisedës.	Të mbijetuarit shpesh përjetojnë stres post-traumatik; qasja e kujdesshme ul rrezikun e ri-traumatizimit.
Gjuhë neutrale dhe mosgjykuese	Përdorni fjalor të qartë, pa paragjykime dhe pyetje të strukturuara me respekt dhe ndjeshmëri.	Forcon ndjenjën e respektit dhe i lejon pacientit të ndajë përvojën në mënyrë të sigurt.
Depistim rutinë i integruar	Përfshijeni pyetjen për DHBGJ në vlerësimet periodike, veçanërisht për grupet vulnerabël (gratë shtatzëna, pacientët me probleme të shëndetit mendor, fëmijët).	Normalizon procesin e identifikimit dhe redukton ndjenjën e stigmës ose veçimit.

Kërkesa Themelore	Standardet dhe Kriteret e Zbatimit	Qëllimi dhe Rëndësia
Respektimi i autonomisë së pacientit	Lejoni pacientin të ndajë informacionin vetëm kur ndihet gati, pa ushtruar presion.	Fuqizon individin dhe respekton të drejtën e tij për vetëvendosje.
Sistem referimi i strukturuar	Siguroni informim të qartë dhe ndërlidhje me shërbime përkatëse: strehim, mbështetje ligjore, këshillim psikologjik etj.	Siguron mbështetje të menjëhershme dhe qasje të integruar në shërbimet përcjellëse.
Njohuri mbi aspektet ligjore dhe etike	Jini të informuar mbi ligjet në fuqi për raportimin e detyrueshëm, konfidencialitetin dhe të drejtat e pacientit.	Garanton përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe mbrojtjen e integritetit të pacientit.
Ndjeshmëri kulturore dhe sociale	Merrni parasysh bindjet, normat dhe pritshmëritë kulturore të pacientit kur formuloni pyetjet dhe interpretimet.	Siguron qasje të respektueshme, e cila rrit gatishmërinë e pacientit për bashkëpunim dhe zbulim.
Zgjedhja e momentit të përshtatshëm (kohë dhe komoditet)	Zhvilloni bisedën në një moment të qetë gjatë konsultës, kur pacienti ndihet i relaksuar dhe nuk ka nxitim.	Rrit efektivitetin e bisedës dhe siguron që pacienti të ndihet i dëgjuar.
Dokumentim profesional dhe i saktë	Regjistroni me kujdes deklaratat, vlerësimet dhe veprimet e ndërmarra në kartelën klinike të pacientit.	Ndihmon në ndjekjen e kujdesit, referimet e mëvonshme dhe mbrojtjen ligjore të të mbijetuarit dhe profesionistit.

Si të Pyetni për Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ)

Të pyesësh një grua nëse ajo ka përjetuar dhunë me bazë gjinore mund të jetë sfiduese, por është një hap thelbësor për të identifikuar dhe mbështetur viktimat. Ky seksion synon të ndihmojë profesionistët e shëndetësisë të fitojnë besim dhe kompetencë në këtë proces delikat, duke promovuar një qasje etike, të ndjeshme dhe pa paragjykime.
Pasi të sigurohet një mjedis i sigurt dhe privat për komunikim, siç përshkruhet më poshtë, profesionistët mund të nisin bisedën me kujdes dhe ndjeshmëri.

Parimet e komunikimit efektiv me viktimën e DHBGJ

- **Merrni iniciativën për të pyetur**, por **kurrë në prani të një partneri, familjari apo miku**. Të pyeturit duhet të ndodhë vetëm në një ambient të sigurt dhe privat.
- **Shpjegoni qartë kufijtë e konfidencialitetit**, duke theksuar se informacioni do të trajtohet me diskrecion, përveç rasteve të rrezikut të menjëhershëm.
- **Përdorni kontakt të ngrohtë me sy** dhe përqendrojeni vëmendjen tek personi që keni përballë. Krijoni ndjesinë se ajo është e dëgjuar dhe e respektuar.
- **Kujdesuni për gjuhën e trupit**: qëndrimi trupor, toni i zërit dhe shprehjet e fytyrës duhet të transmetojnë qetësi, mbështetje dhe hapje.

- **Tregoni dëgjim aktiv**, përmes pohimeve të buta, lëvizjeve të kokës ose fjalive përforcuese si “Po ju kuptoj…”.
- **Mbani një qasje jo-gjykues dhe përkrahëse**. Shmangni pyetjet që nënkuptojnë fajësim, veçanërisht ato që fillojnë me “Pse…”.
- **Pohoni ndjenjat e saj** dhe përforconi se përjetimi i dhunës nuk është asnjëherë faji i viktimës. Përgjegjësia i takon vetëm dhunuesit.
- **Jini të durueshëm dhe mos ushtroni presion** për zbulesë. Viktimat mund të jenë në një gjendje krize ose të paqëndrueshme emocionalisht.
- **Përdorni deklarata mbështetëse**, si:

“Më vjen keq që keni kaluar një përvojë të tillë. Jam këtu për t’ju ndihmuar.”
“Nuk jeni vetëm dhe nuk është faji juaj.”

- **Theksoni se ka ndihmë të disponueshme**, duke ofruar informacione për strehimore, mbështetje ligjore, këshillim psikologjik dhe shërbime të tjera.
- **Filloni me një pyetje hyrëse e cila e normalizon temën**, p.sh.:

“Ne e dimë se shumë gra përjetojnë dhunë në marrëdhënie dhe kjo mund të ndikojë në shëndetin e tyre. A ka ndodhur ndonjëherë që të ndiheni e lënduar apo e kërcënuar nga dikush i afërt me ju?”

🟧 **Shembuj pyetjesh të ndjeshme për të hetuar për përvojat e dhunës me bazë gjinore**

1. “Nga përvoja ime si profesionist/e i/e shëndetit, jam hasur me shumë gra që përjetojnë forma të ndryshme dhune në familje. A ka ndodhur ndonjëherë që të ndiheni të pasigurt apo të dhunuar në marrëdhënien tuaj?”
2. “Ne e dimë se përvoja të tilla janë më të zakonshme sesa mendohet, dhe shpesh ndikojnë në shëndetin fizik dhe emocional të grave. A ka ndodhur ndonjëherë që të jeni ndjerë e frikësuar, e lënduar apo e kontrolluar në shtëpi?”
3. “Disa nga pacientet që vizitoj më kanë treguar për marrëdhënie të vështira apo abuzive. E di që mund të jetë e vështirë të flitet për këtë, por nëse ju ka ndodhur diçka e tillë, mund të flisni me mua me siguri dhe pa gjykim. A ka ndodhur ndonjëherë që partneri juaj të ketë ushtruar dhunë fizike, emocionale apo seksuale ndaj jush?”

🟨 **Shembuj të Pyetjeve të Drejtpërdrejta për Identifikimin e Dhunës me Bazë Gjinore**

1. “Disa nga simptomat që po përjetoni mund të lidhen me përvojën e ndonjë forme dhune. A ka ndodhur ndonjëherë që dikush t’ju ketë lënduar fizikisht?”
2. “Nga përvoja jonë klinike, e dimë se disa dëmtime si këto mund të jenë rezultat i një sulmi fizik. A është diçka që mund t’ju ketë ndodhur ju?”
3. “A ka ndodhur ndonjëherë që partneri, ish-partneri apo ndonjë anëtar i rritur i familjes t’ju ketë poshtëruar, kërcënuar ose frikësuar?”
4. “A ndiheni ndonjëherë të frikësuar nga partneri, ish-partneri apo dikush tjetër në familjen tuaj të ngushtë?”
5. “A ka ndodhur ndonjëherë që të keni qenë e detyruar të përfshiheni në marrëdhënie seksuale pa dëshirën tuaj?”
6. “A është përpjekur ndonjëherë partneri juaj të kontrollojë veprimet tuaja, t’ju kufizojë kontaktin me të tjerët ose t’ju ndalojë të bëni gjëra që janë të rëndësishme për ju?”

Seksioni III – Trajtimi dhe Dokumentimi i dhunës me bazë gjinore

Ofruesit e shërbimeve shëndetësore kanë një përgjegjësi etike dhe ligjore për të trajtuar dhe dokumentuar detajet e çdo konsultimi me një pacient. Kjo përfshin jo vetëm atë që raporton pacienti (rrëfimin e tyre të ngjarjeve), por edhe vëzhgimet dhe veprimet e ndërmarra nga ofruesi shëndetësor gjatë konsultimit (p.sh., ekzaminimet fizike, trajtimet ose testet). Këto shënime duhet të ruhen dhe të trajtohen në mënyrë konfidenciale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretin profesional. Informacioni mund t'u komunikohet autoriteteve përgjegjëse vetëm kur ekziston pëlqimi i vlefshëm i pacientit ose një bazë ligjore që e lejon apo e kërkon këtë komunikim, duke respektuar parimin e minimizimit të të dhënave dhe dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 11/2026..

Dokumentacioni nuk është vetëm për qëllime klinike. Të dhënat mjekësore mund të përdoren si provë në procedurat ligjore. Nëse një pacient ka përjetuar dhunë, shënimet mund të shërbejnë për të dhënë kontekstin dhe detajet që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, veçanërisht në rastet e DHBGJ. Të dhënat mund të përfshijnë gjithashtu informacion në lidhje me dëmtimet fizike, ndikimet psikologjike dhe rrethanat rreth incidentit.

Kur një ofrues shërbimi shëndetësor dokumenton shenja të dhunës fizike ose seksuale, mund t'i kërkohet të kryejë një ekzaminim mjeko-ligjor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur lëndimet ose traumat e viktimës duhet të vlerësohen në kontekstin e hetimeve penale. Roli i ofruesit mund të përfshijë dhënien e dëshmisë së ekspertit në gjykatë nëse është e nevojshme.

Nga ana tjetër, nëse një pacient ka qenë viktimë e DHBGJ, dokumentacioni mund të ndihmojë ofruesit e ardhshëm të kujdesit shëndetësor të kuptojnë situatën e pacientit. Kjo mund të sigurojë që pacienti të marrë kujdesin, mbështetjen dhe shërbimet e duhura përcjellëse.

Trajtimi i rastit të dhunës dhe ofrimi i kujdesit mjekësor

Hapi 1

🟩 Sigurimi i Privatësisë dhe Sigurisë së Viktimës së DHBGJ

Hapi i parë dhe më i rëndësishëm në komunikimin me një të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore është krijimi i një mjedisi **të sigurt dhe konfidencial**. Viktima duhet të ndjehet e mbrojtur nga gjykimi, frika e ndëshkimit apo ekspozimit. Vetëm në një ambient të tillë, ajo mund të ndajë përvojën e saj dhe të pranojë hapur që është viktimë e dhunës.

👉 **Rekomandime për mënyrën e komunikimit me viktimën:**

- “Më vjen keq që keni kaluar një përvojë kaq të dhimbshme. Jam këtu për t'ju dëgjuar dhe për t’ju mbështetur.”
- “E kuptoj se kjo mund të jetë shumë e vështirë për t’u ndarë. Ju falënderoj për besimin që po më tregoni.”
- “Kjo është një hapësirë e sigurt. Mund të flisni pa frikë dhe pa u gjykuar.”
- “Ju jeni në kontroll të kësaj bisede. Ndani vetëm atë që ndiheni rehat të ndani.”
- “Nëse ndiheni të pasigurt apo të shqetësuar, thoni fjalën në çdo moment dhe mund të ndalojmë menjëherë.”

- “Informacioni që ndani me ne do të trajtohet me konfidencialitet. Në rastet kur ligji kërkon raportimin ose ndarjen e informacionit me institucionet përgjegjëse, do t'ju shpjegojmë detyrimet tona dhe mënyrën e veprimit, duke respektuar sigurinë dhe të drejtat tuaja.
- “Do të shqyrtojmë së bashku mundësitë për ndihmë dhe mbështetje – nga strehimi te këshillimi apo mbështetja ligjore.”
- “Nëse dëshironi, mund t’ju lidh me një profesionist të shëndetit mendor apo me një strehë të sigurt për gra.”
- “Në çdo moment, mund të riktheheni këtu për ndihmë. Kjo hapësirë është gjithmonë e hapur për ju.”
- “Nëse ndiheni gati, mund të flasim për çdo dëmtim fizik që keni përjetuar, dhe unë mund t’ju ofroj kujdesin mjekësor të duhur.”
- “Nëse keni qenë viktimë e abuzimit seksual, mund t’ju ndihmojmë për të parandaluar infeksionet ose për të dokumentuar dëmtimet, nëse dëshironi të ndërmerrni hapa ligjorë.”

🔒 **KUJDES! Informoni të mbijetuarën se të gjitha informacionet e ndara do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, përveç rasteve kur ka një rrezik të mundshëm për dëmtim të mëtejshëm ose kur raportimi është i detyrueshëm sipas ligjit (p.sh., në rastet që përfshijnë të mitur).**

Hapi 2 – Sigurimi i Pëlqimit të Informuar

🔷 **Informoni me kujdes të mbijetuarën për procedurat që do të ndiqen:**
- Shpjegoni qartë hapat e ekzaminimit mjekësor, rëndësinë e dokumentimit të dëmtimeve, mundësinë e mbledhjes së provave mjeko-ligjore dhe procedurat e raportimit të mundshëm.
- Siguroni që ajo të kuptojë të drejtat e saj dhe të ketë mundësinë të vendosë vetë për secilin prej këtyre hapave.

🔷 **Pëlqimi i informuar duhet të jetë i qartë dhe i dokumentuar:**
- Mos vazhdoni me asnjë ekzaminim, dokumentim apo proces raportimi pa marrë pëlqimin eksplicit të mbështetur në informacion të plotë.
- Nënvizoni të drejtën e saj për të zgjedhur nëse do të raportojë apo jo rastin tek autoritetet.

🔷 **Respektojeni autonominë e saj në çdo moment:**

“Çdo vendim është në dorën tuaj – ne jemi këtu për t’ju ofruar mundësi, jo për t’ju detyruar.”

“Ju keni të drejtën të vendosni vetë për çfarëdo hapi që ndërmarrim. Ne jemi këtu për t’ju mbështetur.”

“Nëse nuk ndiheni gati për të folur tani, mund të riktheheni kurdoherë – dera jonë është gjithmonë e hapur.”

Nëse përgjigjja është “jo” për ndonjë hap:
- Mos ushtroni presion. Respektoni refuzimin dhe ndaloni menjëherë çdo veprim të mëtejshëm.
- Rikonfirmoni disponueshmërinë tuaj.

“Nëse ndonjëherë ndiheni gati për të folur apo kërkuar ndihmë, jemi këtu për ju.”

- Siguroni informacion të dobishëm. Jepni kontakte të shërbimeve mbështetëse, strehëzave apo këshilltarëve.
- Sugjeroni rishikim të mëvonshëm. Nëse e përshtatshme, sugjeroni një vlerësim të dytë kur kushtet ta lejojnë.

Për dokumentimin në kartelën mjekësore:

- Nëse ka dyshime për dhunë, por pacientja nuk pranon:

"U bë një vlerësim për dhunë gjatë kësaj vizite, por pacientja nuk pranoi se ka përjetuar abuzim."

- Argumentoni dyshimet mjekësore me formulime neutrale si:

"Gjetjet fizike nuk përputhen plotësisht me historinë e paraqitur."
"Pacientja paraqet shenja të mundshme të dhunës fizike ose emocionale."

Me përjashtim të veprimeve që janë detyrime ligjore (raportimi i rastit të DHF-së/DHBGJ-së, kur përbën vepër penale, në polici) çdo veprim tjetër duhet të kryhet pas marrjes së pëlqimit paraprak të informuar të të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, pra pasi t'i jetë dhënë asaj informacioni i nevojshëm për të gjykuar dhe dhënë këtë pëlqim. Edhe në rast të veprimeve që duhet të kryhen, sepse janë detyrime ligjore, është shumë e rëndësishme që i/e mbijetuari/a subjekt i DHF-së/DHBGJ-së të informohet për këtë detyrim ligjor dhe hapat që do të ndërmerren.

URDHËR
Nr. 102, datë 21.2.2020

Hapi 3 – Kryeni një Ekzaminim Mjekësor Gjithëpërfshirës

Ekzaminimi mjekësor i një të mbijetuare të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht në rastet e dyshuara të dhunës seksuale, kërkon një qasje të ndjeshme, profesionale dhe të standardizuar, duke garantuar njëkohësisht sigurinë, dinjitetin dhe të drejtat e pacientit.

🔷 **1. Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme fizike**

- Kryeni një **ekzaminim fizik të plotë dhe sistematik**, duke filluar me kontrollin e përgjithshëm të gjendjes vitale (presioni i gjakut, pulsi, frymëmarrja, temperatura).
- Vlerësoni **shenjat e traumës fizike**: prerje, gërvishtje, mavijosje, hematoma, djegie, fraktura të mundshme ose shenja mbytjeje.
- Inspektoni me kujdes pjesët më të ekspozuara ndaj dhunës, përfshirë fytyrën, qafën, gjoksin, krahët dhe këmbët.

🔷 **2. Vlerësimi i sistemit kardiovaskular dhe respirator**

- Monitoroni **shenjat vitale** për të identifikuar stresin akut, gjendjen e shokut ose simptoma të tjera emergjente (p.sh., presion i ulët i gjakut, takikardi, frymëmarrje e shpejtë).
- Ekzaminoni pacientin për **dhimbje në kraharor, aritmi**, ose simptoma që mund të lidhen me ankthin ose reagime fizike ndaj traumës.

🔷 **3. Vlerësimi i gjendjes gjenitale dhe rektale (në rastet e dhunës seksuale)**

- Me pëlqimin e qartë të të mbijetuarës, kryeni **ekzaminimin e zonës gjenitale dhe anale**, në mënyrë delikate dhe etike.
- Kërkoni për **shenja të dëmtimit**: laceracione, çarje, mavijosje, sekrecione të pazakonta ose shenja infeksioni.

🔷 **4. Vlerësimi i shëndetit mendor**

- Vlerësoni **gjendjen emocionale dhe psikologjike** të të mbijetuarës për shenja të ankthit, stresit post-traumatik (PTSD), depresionit ose mpirjes emocionale.
- Identifikoni nevojat për **ndërhyrje urgjente në shëndetin mendor** dhe referoni tek specialistët kur është e nevojshme.

🔷 **5. Mbledhja e provave mjeko-ligjore**

- Në përputhje me protokollet mjeko-ligjore kombëtare/internacionale, mblidhni prova si:
  - **Shtupa vaginale, rektale, orale**
  - **Mostra të thonjve, flokëve, lëkurës**
  - **Rrobat e veshura gjatë ngjarjes**
  - **Fotografi të lëndimeve** (me pëlqim të nënshkruar)
- Përdorni **paketime sterile** dhe formularë të posaçëm për dokumentim.
- Siguroni **ruajtjen, etiketimin dhe dorëzimin korrekt** të provave në institucionet përkatëse, sipas standardeve ligjore.

🔷 **6. Dokumentimi mjekësor dhe ligjor**

- Regjistroni **të gjitha gjetjet në kartelën klinike**, duke përdorur gjuhë neutrale dhe të faktuar.
- Përdorni **formulime objektive**, si: "pacientja raporton", "observohen mavijosje të freskëta në..." etj.
- Përfshini:
  - Vendin, formën dhe madhësinë e çdo dëmtimi.
  - Përshkrimin e ngjyrës së mavijosjeve (për të ndihmuar përcaktimin e kohës së ngjarjes).
  - Vlerësimin e gjendjes mendore dhe emocionale.
- Nëse bëhen fotografi, sigurohuni që ekziston **pëlqimi i dokumentuar me shkrim** nga pacientja.

Hapi 4 – Siguroni Kujdes dhe Trajtim të Menjëhershëm

Pas identifikimit të një rasti të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), profesionistët shëndetësorë duhet të sigurojnë ndërhyrje të menjëhershme për të adresuar si nevojat fizike, ashtu edhe ato emocionale të viktimës, duke garantuar sigurinë e saj të menjëhershme dhe duke e orientuar drejt shërbimeve të specializuara.

✅ **1. Menaxhimi i nevojave mjekësore urgjente**

- Trajtoni çdo dëmtim fizik të dukshëm apo të raportuar, si:
  - **Pastrimi, dezinfektimi dhe fashimi i plagëve**
  - **Menaxhimi i dhimbjes dhe dëmtimeve të brendshme apo frakturave**
- Siguroni **kujdes të menjëhershëm për IST (infeksione seksualisht të transmetueshme)**, përfshirë testim dhe trajtim sipas nevojës.
- Ofroni **kontracepsion urgjent**, në rast të një sulmi seksual, duke respektuar zgjedhjen e pacientes.
- Informoni mbi opsionet për **profilaksi pas ekspozimit (PEP)** në rast rreziku për HIV.

✅ **2. Mbështetje e menjëhershme psikologjike**

- Ofroni një **hapësirë të sigurt emocionale** dhe dëgjim aktiv pa gjykim.

- Vlerësoni gjendjen emocionale të viktimës dhe **shenjat e stresit post-traumatik**, ankthit ose shokut.
- Nëse viktima shfaq shenja të rënduara emocionale, **referojeni menjëherë tek shërbimet e shëndetit mendor ose mbështetje psikologjike të specializuar**.
- Siguroni informacion të qartë për mundësitë e mbështetjes së mëtejshme.

✅ **3. Vlerësimi i rrezikut për sigurinë personale**

Përdorni një qasje empatike dhe të drejtpërdrejtë për të kuptuar rrezikun e vazhdueshëm të dhunës. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të rrezikut:

- A ndiheni të sigurt në banesën ku jetoni aktualisht?
- A ka ndodhur ndonjëherë që partneri juaj ju ka kërcënuar për jetën tuaj ose të dikujt tjetër që doni?
- A ju ka ndaluar ndonjëherë të kërkoni ndihmë ose t'ia tregoni dikujt tjetër çfarë po ndodh?
- A është përpjekur të ju ndjekë, kontrollojë ose frikësojë nëse keni folur për dhunën?
- A keni përjetuar dhunë të përsëritur ose përshkallëzim të situatës me kalimin e kohës?
- A ndiheni të shqetësuar se dhuna mund të ndodhë sërish në të ardhmen e afërt?
- A keni një vend ku mund të shkoni për të qenë të sigurt? A ka dikush që mund t'ju ndihmojë për t'u larguar nga situata?
- A janë fëmijët tuaj të përfshirë në këtë situatë? A janë ata të rrezikuar apo kanë qenë dëshmitarë të dhunës?

Nëse vlerësimi nxjerr në pah një **rrezik të lartë**, duhet të aktivizohen menjëherë mekanizmat e mbrojtjes dhe të ofrohet ndihmë për vendosjen në strehimore, njoftimin e autoriteteve dhe kontaktin me shërbime të emergjencës sociale.

Hapi 5 – Referimi në Shërbime të Specializuara

Një ndër elementët më të rëndësishëm të mbështetjes për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore është orientimi drejt një rrjeti të koordinuar të shërbimeve mbështetëse.

✅ **Referimi te specialistët**

- Ofroni ndihmë për të lidhur pacientin me **shërbime të specializuara për viktimat e DHBGJ**, duke përfshirë qendrat e krizës, strehimoret, organizatat e shoqërisë civile, psikologë të specializuar dhe punonjës socialë.
- Sigurohuni që referimi të bëhet në mënyrë **të sigurt, konfidenciale dhe me pëlqimin e informuar të viktimës**, duke shmangur çdo rrezik të ekspozimit apo stigmatizimit.

✅ **Informimi për shërbimet mbështetëse**

- Jepni një **listë me kontakte dhe informacion praktik** për burimet në dispozicion:
  - Linjat telefonike emergjente ose këshilluese
  - Strehimoret për gra dhe fëmijë
  - Shërbimet e ndihmës ligjore falas
  - Qendrat komunitare ose zyrat e mbrojtjes sociale
- Shpjegoni rolin e secilit shërbim në mënyrë të qartë dhe me ndjeshmëri, për t'i dhënë të mbijetuarës mundësinë të vendosë vetë se çfarë mbështetjeje dëshiron.

Hapi 6 – Raportimi Ligjor

Raportimi është një aspekt kompleks që kërkon balancimin midis të drejtave të viktimës dhe detyrimeve ligjore të profesionistit shëndetësor.

✅ **Raportimi i detyrueshëm për të miturit**

- Në përputhje me **Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri**, çdo dyshim apo njohje e dhunës ndaj një të mituri (nën 18 vjeç) **duhet të raportohet menjëherë** në:
  - Polici
  - Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social
  - Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës në nivel bashkie
- Raportimi duhet të jetë i dokumentuar dhe të ndodhë **pa nevojën e pëlqimit të prindërve ose kujdestarit ligjor**, kur ekziston rrezik për fëmijën.

✅ **Bashkëpunimi me autoritetet ligjzbatuese**

- Nëse viktima është e rritur dhe **pranon të raportojë**, mbështeteni procesin me:
  - Sigurimin e kopjeve të dokumentacionit mjekësor
  - Dorëzimin e provave mjeko-ligjore të mbledhura
  - Ndihmën për të kontaktuar Policinë e Shtetit ose Prokurorinë

Kujdes! Respektoni **autonominë e pacientit** dhe mos nxitoni për të raportuar pa pëlqimin e saj, përveç rasteve të parashikuara nga ligji.

